

BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE *(Bulletin on Natural Hazards)***Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore**Facebook page : [Instituti i Gjeoshkencave](#), Webpage: www.geo.edu.al**Buletini Nr. 44 / 2026, 13-02-2026****Parashikimi** nga 13-02-2026, ora 12:00 deri 14-02-2026, ora 23:59.**PARASHIKIMI METEO****RESHJET**

Sot pasdite (e premte, dt. 13) priten reshje të dobëta deri lokalisht mesatare të shoqëruara me shtrëngata në qarkun Vlorë, ndërsa në qarqet e tjerë priten reshje të dobëta.

Nesër (e shtunë, dt. 14) priten reshje mesatare deri lokalisht intensive në qarqet Shkodër, Vlorë dhe Gjirokastrë, ndërsa në qarqet e tjerë priten reshje mesatare të shoqëruara me shtrëngata (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark). Në Veri, Lindje dhe Jug Lindje të vendit, në lartësitë mbi 900 m nga niveli i detit reshjet pritet të jenë në formë dëbore.

Nesër (e shtunë, dt. 14) shtrëngatat dhe intensiteti i lartë i reshjeve, mund të krijojnë probleme të ndryshme, si rënie gurësh e inertesh dhe vërshime të ujit në zonat urbane të lokalizuara, në varësi të sistemit të kanalizimeve në qarqet Vlorë dhe Gjirokastrë.

TEMPERATURA

Nesër (e shtunë, dt. 14) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë:

në bregdet: 9 / 14 °C

në vendet e ulëta: 7 / 15 °C

në vendet malore: 3 / 10 °C

ERA

Sot pasdite (e premte, dt. 13) dhe nesër (e shtunë, dt. 14) era pritet të fryjë e lehtë deri mesatare, për momente të shkurtra deri e fortë kryesisht në bregdet.

NIVELET E RREZIKUT**S'KA RREZIK****I ULËT****I MODERUAR****I LART**

Instituti i Gjeoshkencave – IGJEO

Specialist: Anira Gjoni

Koordinator: Elona Abazi (Tel: +355 69 311 9392, e-mail: albania.hazards@gmail.com)

faqe 1 / 3

BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE (Bulletin on Natural Hazards)**Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore**Facebook page : Instituti i Gjeoshkencave, Webpage: www.geo.edu.al**Buletini Nr. 44 / 2026, 13-02-2026****Parashikimi** nga 13-02-2026, ora 12:00 deri 14-02-2026, ora 23:59.**PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)**

RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT	Zjarre në pyje	Ngjarje Meteorologjike			Ngjarje Hidrologjike		
	Zjarret Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Maksimale të lokalizuara	Shtrëngata	Përmbytje të Shpejta	Përmbytje Lumenjsh	Rrëshqitje toke
SHKODËR	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
KUKËS	S'KA RREZIK	mesatare					
DIBËR	S'KA RREZIK	mesatare					
LEZHË	S'KA RREZIK	mesatare					
DURRËS	S'KA RREZIK	mesatare					
TIRANË	S'KA RREZIK	mesatare					
ELBASAN	S'KA RREZIK	mesatare					
FIER	S'KA RREZIK	mesatare					
BERAT	S'KA RREZIK	mesatare					
KORÇË	S'KA RREZIK	mesatare					
VLORË	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
GJIROKASTËR	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				

BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE (Bulletin on Natural Hazards)**Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore**Facebook page : [Instituti i Gjeoshkencave](#), Webpage: www.geo.edu.al**Buletini Nr. 44 / 2026, 13-02-2026****Parashikimi** nga 13-02-2026, ora 12:00 deri 14-02-2026, ora 23:59.**LEGJENDA: Reshjet 24-orëshe**

Niveli i Rrezikut	Reshje shiu (mm / 24 orë)
S'KA RREZIK	të dobëta (0 – 15 mm / 24 orë) Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike.
I ULËT	mesatare (15 – 45 mm / 24 orë) Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike.
I MODERUAR	intensive (45 – 90 mm / 24 orë) Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike.
I LARTË	shumë intensive (> 90 mm / 24 orë) Moti është shumë i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonshme hidro-meteorologjike mjaft intensive.

LEGJENDA: Zjarre në pyje

S'KA RREZIK	Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht.
ULËT	Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë te mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara.
I MODERUAR	Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme.
I LARTË	Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë.

**RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT
për sot dhe nesër, dt. 13–14.****SIMBOLE**

	Shtrëngata: reshje mbi 20 mm/3orë. Moti mund të krijojë probleme të ndryshme
	Përmbajtje urbane ose nga përrenjtë dhe lumenjtë e vegjël
	Përmbajtje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj
	Rrëshqitje toke